

VENDIM
Nr.16, datë 13.7.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i“ “
Kristofor Peçi	Anëtar i“ “
Kujtim Puto	Anëtar i“ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i“ “
Petrit Plloçi	Anëtar i“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i“ “

me sekretare Arbenka Lalice, në datat 28.2.2005 dhe 15.4.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.21 Akti, që i përket:

KERKUES:FATBARDHA ALIZOTI, përfaqësuar nga avokat Viktor Konomi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. BARDHYL METULI, në mungesë.

2. SABAUDIN, ARJANA E ALI METULI, përfaqësuar nga avokat Arqile Nini, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.400, datë 20.3.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1129, datë 27.5.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme, kërkesja ka parashtruar këto shkaqe:

- Në shqyrtimin e kërkesës ankimore, paraqitur nga pala e paditur, nuk është vënë në dijeni nga Gjykata e Apelit Tiranë për datën e për pasojë nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor;
- Gjykata e apelit kishte shkaqe që të shtynte shqyrtimin e çështjes, gjë që nuk e ka kryer;
- Në gjykimin e rekursit në Gjykatën e Lartë, ka marrë pjesë një gjyqtare, e cila kishte marrë pjesë në gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Alfred Karamuço, përfaqësuesit e palëve, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkesja Fatbardha Alizoti, mbi bazën e testamentit të lënë nga nëna, ka regjistruar si pronë të saj një banesë dhe një kopësht. Ajo ka ngritur padi kundër Bardhyl, Sabaudin, Merxhivan, Arjan e Ali Metuli, duke kërkuar pushimin e cenimit të pronësisë, si dhe lirim të sipërfaqeve të zëna. Ndërkohë të paditurit, kanë ngritur kundërpadi, ku kanë kërkuar të njihen pronarë për sipërfaqe të caktuara toke.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3519, datë 18.9.2002, ka pranuar pjesërisht padinë, si dhe ka rrëzuar kundërpadinë. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim të paditurit dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.400, datë 20.3.2003, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit duke rrëzuar padinë e Fatbardha Alizotit dhe pranuar kundërpadinë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1129, datë 27.5.2004, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit.

Në tërësinë e këtyre proceseve e vendimeve gjyqësore konkrete, Gjykata Kushtetuese nuk gjen elemente të procesit të parregullt ligjor, ashtu siç pretendohet nga kërkesja.

Vërtetohet se në vendimin e gjykatës së rrethit ka pasur një gabim material lidhur me vendndodhjen e disa shtesave ndërtimi pa leje, të cilat duheshin prishur. Pa përfunduar këto procedura të korrigjimeve materiale, gjykata e apelit ka shpallur ditën dhe orën e gjykimit të kërkesës ankimore

të të paditurve Bardhyl Metuli etj., (kopje e së cilës i është dorëzuar paditëses) duke kryer normalisht detyrimet që rrjedhin nga neni 460 i Kodit të Procedurës Civile.

Është fakt, që në shqyrtimin e ankimit në gjykatën e apelit nuk ka marrë pjesë si paditësja ashtu dhe përfaqësuesi i saj. Kërkesja këtë mungesë e argumenton me faktin se shqyrtimi i çështjes në shkallën e dytë nuk mund të bëhet pa u korrigjuar gabimet materiale të vendimit gjyqësor, konform nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata Kushtetuese konstaton se në këtë dispozitë, si dhe në tërësi në Kodin e Procedurës Civile, nuk ka ndonjë rregull të vendosur sipas të cilit, korrigjimi i gabimeve me karakter teknik të përbëjë shkak për shtyrjen apo pezullimin e gjykimit të ankimeve ndaj këtij vendimi. Për më tepër, neni 312 i Kodit të Procedurës Civile nuk vendos afat për korrigjimet e as ndonjë kusht pezullues, përkundrazi, nga vetë përmbajtja e dispozitës del e qartë se korrigjimi nuk ka afat dhe nuk lidhet me fatin e çështjes.

Në këto kushte, mospjesëmarrja e kërkueses dhe e përfaqësuesit të saj në Gjykatën e Apelit Tiranë, nuk vjen për shkaqe që varen nga gjykata e për rrjedhojë kjo e fundit nuk ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese ka tashmë jurisprudencë të konsoliduar sipas së cilës, procesi i parregullt gjyqësor duhet kërkuar para së gjithash në veprimet e gjykatave, në faktin se sa dhe si ato kanë respektuar detyrimet kushtetuese dhe ligjore për të garantuar të drejtat e qytetarëve në një proces gjyqësor.

Kërkesja ka parashtruar si shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor edhe pjesëmarrjen e një gjyqtareje në Gjykatën e Lartë në shqyrtimin e rekursit, në një kohë kur po kjo gjyqtare ka qenë pjesëmarrëse, e për më tepër relatore në Gjykatën e Apelit Tiranë, në shqyrtimin e çështjes. Gjykata Kushtetuese konstaton se në gjykatën e apelit, gjyqtarja nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e themelit të çështjes, por për kërkesën për ndreqjen e gabimit material. Në këto kushte, nuk vërtetohen rastet e cenimit të paanësisë së gjyqtarit e për pasojë, shkak për përjashtimin e tij sipas neneve 72-74 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.